



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 74, datë 04.10.2019

PËR
AKREDITIMIN E PARË TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË,
MASTER I SHKENCAVE NË “FINANCË DHE KONTABILITET”, ME PROFILE:
“FINANCË DHE BANKË”; “KONTABILITET DHE AUDITIM”, TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 04.10.2019, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në “Financë dhe Kontabilitet”, me profile: “Financë dhe Bankë”; “Kontabilitet dhe Auditim”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 567, datë 02.12.2016
- d) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- e) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesi
- f) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- g) Kredite (ECTS): 120 kredite
- h) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- i) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht

- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Raportimin e ekspertëve të vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e Institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në Institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe pengesat, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;
- e. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të Standardeve Shtetërore “Për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë të IAL” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësinë si më poshtë:
 - i. Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese nuk është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin Përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Master i Shkencave** në **“Financë dhe Kontabilitet”**, me profile: **“Financë dhe Bankë”**; **“Kontabilitet dhe Auditim”**, të Kolegjit Universitar **“Instituti Kanadez i Teknologjisë”**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë)** vite akademike.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2024**.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA		Kryetar
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
FABRICE HENARD		Anëtar
ARBEN MERKOCI		Anëtar
ALEKSANDËR XHUVANI		Anëtar
ANILA PAPANISTO		Anëtar
SULO HADERI		Anëtar
LULJETA MINXHOZI		Anëtar
MYFTAR BARBULLUSHI		Anëtar
ILIR PANDA		Anëtar
FATMIR GURI		Anëtar

Shënim: Z. M. Barbullushi nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 76, datë du. 10. 2019, “Për akreditimin e parë të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “**Financë dhe Kontabilitet**”, me profile: “**Financë dhe Bankë**”; “**Kontabilitet dhe Auditim**”, të Kolegjit Universitar “**Instituti Kanadez i Teknologjisë**”, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë kategorizimin e lëndëve sipas veprimtarive formuese, në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*”.
2. Institucioni, të shohë mundësinë e rritjes së numrit të orëve në auditor për punimin e diplomës në mënyrë që studentëve t’u jepet mundësia që të jenë më shpesh në kontakt me tutorët e tyre.

